



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality Assambly
Hani i Elezit



01/Nr. 5751/2023
Data : 11.07.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.05.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nnkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Luljeta Daci** (Asistente në Zyrën e Kryetarit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.
3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
5. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2024.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës propozoj që të hyjnë edhe dy pika të rendit të punës. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hanit të Elezit 2023 – 2025. Për pikat shtesë hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Rendin e punës në tërësi e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.
3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
5. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2024.
6. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.
7. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hanit të Elezit 2023 – 2025.
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2024-2026.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në bazë të qarkores buxhetore e cila na është dërguar nga Ministria e financave është hartuar Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2024-2026 e cila përmban planifikimet nga financimet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake të komunës për vitin 2024-2026. Planifikimi i buxhetit për vitin 2024 është në shumë prej 3,349,278.00 €, planifikimi i buxhetit për vitin 2025 është në shumë prej 3,521,381.29€, planifikimi i buxhetit për vitin 2026 është në shumë prej 3,693,420.00 €. Është mbajtur dëgjimi buxhetorë për Korniza Afatmesme Buxhetore Nëse keni ndonjë vërejtje dhe sugjerim mund të parashtroni

Refet Kalisi thekson:- pse nuk e keni shënuar financimin e investimeve kapitale për vitin 2024-2026. Të hyrat vetanake në këtë vit kanë qenë 560 000 € ndërsa për vitin 2024 janë në shumë prej 274 000 €.

Lindita Ballazhi thekson:- nuk i kemi shënuar për shkak se kemi menduar me i marr edhe propozimet e qytetarëve dhe me përcjell materialin. Për mbledhje të kuvendit të komunës do ta keni të plotësuar. Arsyeja pse janë ulur të hyrat vetanake është për shkak se kemi bërë kërkesa të shumta që të zvogëlohet projekcioni i të hyrave vetanake dhe fatmirësisht e ka aprovuar Ministria.

Sherif Berisha thekson:- në cilat shkolla planifikohen të ndërtohen fusha sportive.

Hisni Luri thekson:- do të investohet në sallën sportive të shkollës fillore “Ilaz Thaçi” përveç se është ndriçimi i dobët nuk janë në rregull edhe anësoret dhe rrjetat . Në kornizë kemi planifikuar që të bëhet mirëmbajtja e tyre. Në sallën sportive të shkollës fillore “Veli Ballazhi” e kemi bërë rrethojën që ka qenë më emergjente por ka edhe çështje të tjera që duhet të rregullohen . duhet të rregullohet kulmi i sallës sportive në shkollën fillore “Kështjella e Diturisë”

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2024-2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:-nga nëtë të gjetura për vitin 2021 për vitin 2022 kemi pesë të gjetura. Në përgjithësi opinioni i auditimit është pozitiv. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- a e keni komplet raportin e auditimit apo mungon ndonjë fletë për shkak se pika një dhe dy nuk është. Auditorët kanë potencuar se 91 % e buxhetit është shpenzuar, ndërsa ju keni potencuar se mbi 95 % e buxhetit është shpenzuar .

Sherif Berisha thekson:- komuna e Hanit të Elezit për vitin 2022 ka shpenzuar 90.20 % të buxhetit dhe mjetet e tjera ku kanë mbetur.

Lindita Ballazhi thekson:- për kuvend do ta plotësoj sepse është gabim teknik. Çështja e shpenzimit të buxhetit varet se për cilën kategori të shpenzimeve kam potencuar sepse 95 % nuk është shpenzuar buxheti.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINACIARE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani i Veprimit të Komunës për zbatimin e rekomandimeve të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- të gjeturat në raportin e auditimit i kemi përcaktuar në plan se si planifikohen për me i realizuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS PËR ZBATIMIN E REKOMANIDMEVE TË AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINACIARE VJETORE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Kryesuesi thekson:- është procedurë që duhet të themelohet grupi punues dhe nëse jeni në dakord në grupi punues propozoj të jenë anëtarët e komitetit për Politikë e Financa. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë e shpenzimeve kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- në material janë dhënë të gjitha detalet dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- a shuhen projektet e kodeve të më hershme.

Lindita Ballazhi thekson:-janë projekte që edhe nuk kanë filluar dhe mjetet e tyre i marrim në projekte të cilët kanë mjete për shkak të ngritjes së çmimeve shumë kanë ndryshuar.

Refet Kalisi thekson:- unë mendoj se nëse i marrim dhjetë projekte për me i realizuar është mirë me i pasur mjetet financiare.

Lindita Ballazhi thekson:- i kemi disa projekte të cilat janë me bashkë financim me Ministri të ndryshme dhe për këtë arsye e mbajmë një projekt sa me pasur kodin në mënyrë që nëse kemi ndonjë donacion me pasur si kodë buxhetorë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KËRKESA PËR RIALOKIM TË MJETEVE FINANCIARE NË KATEGORINË E SHPENZIMEVE KAPITALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Hanit të Elezit 2023 – 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- është dërguar me material shtesë për shkak se ka kërkuar Ministria e Punëve të Brendshme. Shumica e komunave e kanë miratuar këtë plan dhe për atë kemi propozuar që edhe komuna jonë ta procedon më tutje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIADHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE

8. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- në atë pjesë aq ka pasur mundësi për me intervenuar , në të ardhmen do të shikohen mundësitë nëse ka mundësi do të mundohemi me rregulluar .

Sherif Berisha thekson:- pse nuk është bërë zgjerimi i urës ka pjesa e anës së fshatit Seçishtës .

Refet Kalisi thekson:- unë mendoj se është dashur në këtë vit me u rregulluar pjesa e anës së fshatit Seçishtës.


Nexhmedin Daci thekson:- fillimisht duhet të merret mendimi i ekspertëve dhe për vitin e ardhshëm mundemi me planifikuar mjete financiare për me realizuar vitin e ardhshëm.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:38.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

Florim Shkreta

